



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.224/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj kryesuese, Afjete Sada Gllogjani dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Vlerona Maliqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK), me seli në Pejë, të paraqitur kundër subjektit politik Partia Liberale Egjiptiane (PLE), me seli në Gjakovë, për shkak të përdorimit të fëmijëve në fushatë zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 06 tetor 2019, në seancën e panelit të mbajtur më datë 05.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHEȚ e pabazuar ankesa Anr.224/2019 e datës 04.10.2019, e paraqitur nga subjekti politik Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK), me seli në Pejë, kundër subjektit politik Partia Liberale Egjiptiane (PLE), me seli në Gjakovë, për shkak përdorimit të fëmijëve në fushatë zgjedhore.

A r s y e t i m

Subjekti politik Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK), me seli në Pejë, më datë 04.10.2019, ka paraqitur ankesë në PZAP, kundër subjektit politik Partia Liberale Egjiptiane (PLE), me seli në Gjakovë, me të cilën pretendon se në spotin politik të kandidatit për deputet nga radhët e subjektit politik PLE, Artan Berisha, në prapavijë hasim persona të mitur, të cilët janë nën moshën 18 vjeçare, të cilët shfrytëzohen nga subjekti në fjalë për qëllime politike, ku për vërtetimin e pretendimeve të tij në ankesë, paraqitësi i ankesës si provë ka bashkangjitur një CD dhe disa foto të printuara në cilësi të provave materiale.

Partia Liberale Egjiptiane (PLE), me seli në Gjakovë, në përgjigje në ankesë të datës 05.10.2019, thekson se pretendimet e paraqitësit të ankesës janë të pabazuara, për faktin se pretendimet e paraqitësit të ankesës nuk janë argumentuar me prova të sakta, në harmoni me legjislacionin në fuqi.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi ankesën, vlerësoi se,

Ankesa është e pabazuar, për këto arsyë:

Paneli, vlerëson se pretendimet e paraqitësit të ankesës janë të pabazuara, për faktin se paraqitësi i ankesës nuk ka arritur të argumentojë pretendimet e veta, se nga ana e subjektit politik Partia Liberale Egjiptiane (PLE), janë bërë veprime, të cilat kualifikohen si shkelje të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP) dhe të Rregullave Zgjedhere.


Paneli, vendimin e tij e mbështet në dëshmi të qarta dhe bindëse siç përcaktohet me nenin 117 par.3 të LZP-së, prandaj pretendimet e paraqitura në ankesë, lidhur me përdorimin e

fëmijëve të mitur në fushatë zgjedhore, në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, Paneli vlerësoi se të njëjtat nuk qëndrojnë, për faktin se nga dëshmitë e ofruara nga paraqitësi i ankesës nuk mund të argumentohet mosha e fëmijëve të përfshirë në spotin politik të PLE-së. Paraqitësi i ankesës, në ankesë thirret se shkelja ka ndodhë për faktin se nga ana e këtij subjekti politik gjatë fushatës zgjedhore janë përdorë fëmijë të mitur, në kundërshtim me dispozitat ligjore të rregullave zgjedhore, dhe si dëshmi për pretendimet e tij ka ofruar vetëm një video dhe një fotografi, të cilat janë prova të pamjaftueshme për të konstatuar se nga ana e subjektit politik PLE, janë bërë shkelje të rregullave zgjedhore.

Nga arsyet e theksuara më lartë, e duke u bazuar në nenin 115 par.1 dhe nenin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashresa
Anr.224/2019 më datë 05.10.2019

Kryesuese e Panelit
Kymete Kicaj



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.